

NJOFTIM
Nr. 3503, datë 9.5.2019

**PËR SHPALLJEN E 1 VENDI VAKANT PËR POZICIONIN KËSHILLTAR
EKONOMIK DHE 1 VENDI VAKANT PËR POZICIONIN KËSHILLTAR LIGJOR**

KËSHILLTAR EKONOMIK

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Këshilltarit Ekonomik në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: 80% e G3,

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në shkenca ekonomike, matematike ose në drejtësi me diplomë “master i shkencave” në Shqipëri ose studimet universitare për shkenca ekonomike, matematike ose në drejtësi jashtë vendit dhe të jetë e njësuar sipas legjislacionit në fuqi për njësimin e diplomave;

b) të zotërojnë shumë mirë gjuhën angleze;

c) të kenë shtatë vite përvojë pune në sektorin financiar.

Kushte të përgjithshme:

- kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- ndaj tyre të mos jetë nisur procedim penal, të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtje penale.

- ndaj tyre të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;

2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune (origjinale ose të noterizuar).

4. Dëshmi penaliteti.

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda 20 ditëve pas publikimit të njoftimit pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në adresën; Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna-premte ora 8:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

KËSHILLTAR LIGJOR

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Këshilltarit ligjor në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: 80% e G3,

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

a) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “master i shkencave” në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë diplomë të njësuar sipas legjislacionit në fuqi për njësimin e diplomave;

b) të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze;

c) të ketë shtatë vite përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose në administratën publike.

Kushte të përgjithshme:

- kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015;

- ndaj tij të mos jetë nisur procedim penal, të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtje penale;

- ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;

- kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentat e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;

2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune (origjinale ose të noterizuar).

4. Dëshmi penaliteti.

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda 20 ditëve pas publikimit të njoftimit pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në adresën; Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna-premte ora 8:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit.